



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI RRETHANAT E VEÇANTA PËR PAGESËN NË TITUJ TË KUOTAVE TË FONDIT TË INVESTIMIT

Miraturar me Vendimin e Bordi nr.50, datë 21.03. 2012

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rrethanat e veçanta për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit, si dhe procedurën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim referuar si "Autoriteti") në këtë rast.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore nxirret në përputhje me nenin 115, paragrafi 3, i ligjit "Për Siper marrjet e Investimeve Kollective" nr. 10198, datë 10.12.2009.

Neni 3

Rrethanat e veçanta

Për efekt të kësaj rregulloreje, rrethana të veçanta do të konsiderohen ngjarjet që kanë të bëjnë me:

- a) Stimulimin dhe zhvillimin e fondeve të investimeve, me synim zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri;
- b) Forcimin e stabilitetit financiar në vend;
- c) Parandalimin e pasojave të krizave financiare;
- d) Të tjera ngjarje të miratuara nga Autoriteti, rast pas rasti.

Neni 4

Tregtueshmeria e titujve

Titujt, të cilat do të përdoren për pagesën e kuotave të fondit të investimit duhet të jenë:

- a) tituj që tregtohen në një Bursë të licencuar nga AMF ose,
- b) tituj që tregtohen në një Bursë që operon në një nga vendet e BE, ose
- c) tituj që tregtohen në tregje të tjera të rregulluara dhe të njohura nga AMF.

Përcaktimi i saktë i çmimi të këtyre titujve duhet të jetë i mundur në çdo kohë.

Neni 5

Kërkesa për miratim

Shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive paraqet në Autoritet për miratim kërkesën e argumentuar me dokumentacionin përkatës, për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit, nga investitori potencial.

Neni 6

Miratimi apo refuzimi

1. Autoriteti brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës jep miratimin apo refuzimin për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit.
2. Autoriteti merr vendimin, duke gjykuar:
 - a) argumentin e dhënë nga shoqëria administruese si rrethanë e veçantë;
 - b) përputhshmërinë e titujve që do përdoren për pagesën e kuotave me rregullat e fondit dhe politikën e investimit të publikuar në prospektin e fondit të investimit;
 - c) përfshirjen në prospektin e fondit të investimit të opsionit të pagesës së kuotës me tituj;
 - d) vlerësimin e titujve në përputhje me çmimin e tregut;
 - e) mbrojtjen e interesave të investitorëve të fondit.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Enkeleda SHEHI